



Tirana International Airport

Nënë Tereza



**EKSTRAKT NGA
RAPORTI
VJETOR I TIA-s
2010**

Tirana International Airport SHPK
Aerporti Ndërkombëtar i Tiranës
Nënë Tereza
Godina e Administratës, Rinas
Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 4 2381 600
Fax: +355 4 2381 545
E-Mail: info@tirana-airport.com
Web site: www.tirana-airport.com



Përmbledhje mbi 2010

shkurt 2010

E angazhuar në përgjegjësitë e saj sociale, TIA mbështet familjet e dëmtuara nga përmytjet në veri të Shqipërisë, duke dhuruar 10.000 Euro.

shkurt 2010

Emërohet kryetari i ri i Këshillit administrativ të TIA-s, Z. Linkwiler pasardhës i Dr. Reinhard Kalenda i cili ka mbajtur këtë pozicion që nga fillimi i koncesionit në vitin 2005. Përveç pozicionit si kryetar i ri i Këshillit Administrativ të TIA-s, z. Linkweiler është Drejtor Menaxhues i aksioneve të HOCHTIEF AirPort të TIA-s dhe gjithashtu anëtar i bordit të Korporatës së Aeroporteve të Budapestit dhe Sidnit.

mars 2010

Arritjet e TIA-s dhe potenciali i saj i madh për rritje u prezantuan në një audiencë globale në panairin më të rëndësishëm evropian të industrisë së udhëtimeve ITB në Berlin.

prill 2010

Më 23 prill 2010, Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës feston përvjetorin e pestë. Marrëveshja e koncesionit ndërmjet TIA-s dhe qeverisë shqiptare u nënshkrua më 23 prill 2005, duke themeluar një kompani që u kthye në një investim të fortë dhe tani po demonstroi potencial dhe sukses.

qershor 2010

Me rastin e Ditës Botërore të Mjedisit, TIA organizon një aktivitet pastrimi jashtë Zonës së Koncesionit në afërsi të aeroportit, në bashkëpunim me Shkollën e Rinasit.

gusht 2010

Qeveria shqiptare nis punimet për ndërtimin e godinave të reja, duke përfshirë një kullë të re të kontrollit për Agjencinë Nacionale të Trafikut Ajror (ANTA).

gusht 2010

Më 26 gusht 2010, TIA nderon 100 vjetorin e misionares dhe humanitares së madhe "Nënë Tereza".

tetor 2010

Më 29 tetor 2010 TIA nderohet nga bordi i fondacionit Karitas të Shqipërisë me Çmimin e Mirënjohjes.

dhjetor 2010

15 dhjetor 2010 përfaqëson ditën e parë të liberalizimit të vizave. Duke qenë e përgatitur për një sfidë të tillë, TIA përballoi me sukses rritjen e kërkesës, duke ofruar standarde të larta të shërbimit, si dhe siguri e komfort.

TIA ia përkushton fëmijëve festimet e fund të vitit dhe të përkrah Fshatin e Fëmijëve SOS.

Të dhëna mbi trafikun ajror

Statistikë	Zhvillimet e Trafikut		
	Viti 2010	Viti 2009	Δ %
Pasagjerë	1,536,822	1,394,688	10,2%
ATM-të	10,384	10,032	3.5%
Kargo (tn)	1,946	1,836	4.5%

Viti 2010 tregoi një zhvillim shumë pozitiv të trafikut ajror si në numrin e pasagjerëve dhe atë të lëvizjeve ajrore. Numri i udhëtarëve paraqiti një rritje prej 10,2% gjatë vitit 2010. Viti 2010 është karakterizuar nga dy rënie në zhvillimin e trafikut ajror, i pari u vu re gjatë efektit të hirit vullkanik në prill. Renia e dytë u vu re në periudhën midis vendimit të BE-së për liberalizimin e vizave në tetor dhe hyrjes në fuqi të këtij vendimi: shumë udhëtarë shqiptarë ishin duke pritur për momentin kur udhëtimin pa viza do të bëhej realitet. Sezoni i verës, megjithatë, tregoi një zhvillim pozitiv të trafikut, ku një numër i konsiderueshëm i shqiptarëve që jetojnë jashtë vendit u kthye në shtëpi për pushimet dhe për të vizituar miqtë dhe të afërmit. Trafiku etnik mbetet një faktor kyç në trafikun ajror të TIA-s.

TIA ka ofruar 33 destinacione, me tre itinerare të rinj: Venecia, Heraklion dhe Rodos. Përveç kësaj, TIA ka ofruar lidhje shumë të mirë me anë të shërbimeve me qendër në Romë, Mynih, Vjenë, Stamboll, Lubjanë dhe Budapest. Tregu kryesor mbetet Italia, destinacion i cili mbulon rreth 60% të trafikut në/nga TIA. Belleair është linja ajrore me peshën më të madhe të tregut në TIA, dhe mbuloi gati 44% të tregut për vitin 2010.

Lëvizjet e Trafikut Ajror (ATM), gjithashtu tregojnë një rritje pozitive prej 3.5% për vitin 2010. Rritja e frekuencave të fluturimit në periudhën e pikut veror dhe linja e re ajrore ItAli Airlines, në qershor, kanë ndikuar në mënyrë pozitive në shifrat e TIA-s. Trafikut i transportit të mallrave, paraqiti një rritje prej 4.5% për vitin 2010 në krahasim me 2009.

Zhvillimet e aeroportit

Në 2010 zhvillimi i Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës vazhdoi siç ishte parashikuar nga kompania e cila menaxhon aeroportin në përputhje të plotë me Marrëveshjen e Koncesionit, duke rezultuar me përfundimin dhe dorëzimin e masterplanit 2010 në kohë.

Bazuar në përfundimin brenda afateve kohore, bashkangjitur dhe dokumentacionin tekniko-ligjor nga TIA, janë dhënë lejet për shfrytëzimin e objekteve të mëposhtme:

- Rehabilitimi i pajisjeve në terminalin e vjetër
- Ndërtimi pajisjeve për trajtimin e ujërave të zeza
- Zgjerimi i terminalit të pasagjerëve
- Rehabilitimi i pajisjeve në zonën ajrore dhe stacionin e zjarfikseve
- Zgjerimi i apronit

Është kryer mbikqyrja e projekteve në vijim:

- Ndërtimi i hapësirave të reja për karburantin Air BP në zonën veri-perëndimore të Zonës së Koncesionit.
- Ndërtimi i Godinës së re për kontrollin ajror dhe ndërtimi i kullës së re për kontrollin e trafikut ajror nga ANTA (aktualisht në vazhdim).
- Instalimi i antenave nga Lockheed Martin në brendësi të Sistemit të Uljes në pjesën veri-lindore të Zonës së Koncesionit.

Rruga e re për tek hapsirat dedikuar karburantit Air BP është përfunduar nga TIA.

Mjedisi, Shëndeti, Siguria dhe Cilësia

Gjatë vitit 2010, TIA ka patur serisht në fokusin e saj çështjet mbi cilësinë, mjedisin, shëndetin, dhe çështjet e sigurisë dhe të përgjegjësisë sociale, duke ndërmarrë një sërë masash në kuadrin e cilësisë dhe sistemit të menaxhimit mjedisor. Vëmendje e madhe i është kushtuar integritetit të përkushtimit ndaj mjedisit në aktivitetet e TIA-s dhe monitorimit të vazhdueshëm të parametrave mjedisore si uji, mbeturinat, cilësia e ajrit dhe zhurma.

Në kuadër të zbatimit të konceptit të menaxhimit të mbeturinave në TIA, në mënyrë specifike ndaj konceptit "Ripërdorim-Reduktim-Riciklim", u promovua në bashkëpunim me kompani të tjera ndarja e mbetjeve në burim në mënyrë që të maksimizohet riciklimi dhe të zvogëlohen ndikimet mjedisore. Masa të mëtejshme të rëndësishme në këtë drejtim përfshinin ndërtimin e një hapsire të re të grumbullimit të mbeturinave, blerjen e një kontenieri për mbeturinat e rrezikshme dhe një grumbullues për mbledhjen e mbeturinave të riciklueshme të TIA-s.

Me rastin e Ditës Botërore të Mjedisit, TIA ka ndërmarrë veprime për pastrimin e mjedisit, duke organizuar një fushatë pastrimi jashtë zonës së koncesionit të aeroportit në koordinim me anëtarët e komunitetit dhe nxënësit nga Shkolla e Rinasit shoqëruar nga mësuesit e tyre. Në këtë nismë TIA është mbështetur dhe nga kontraktuesit e saj të cilët bashkëpunuan për një mjedis më të mirë jashtë Zonës së Koncesionit.

Fokusi kundrejt konsumatorëve mbetet një çështje strategjike për TIA-n. Prandaj, cilësia dhe monitorimi i standardeve të performancës është kryer rregullisht nga TIA për të vlerësuar nivelin e shërbimit të ofruar dhe për të verifikuar nëse është arritur niveli i shërbimit në përputhje me kërkesat. Në këtë drejtim, përmirësime të rëndësishme janë ndërmarrë nga TIA të cilat kanë patur një ndikim pozitiv në standardet e performancës dhe cilësisë së shërbimeve. TIA kreu për herë të parë një anketim mbi kënaqësinë konsumatore në terminalin e mallrave dhe realizoi një studim sasior në terminalin e pasagjerëve. Niveli i përgjithshëm i përshtypjeve të klientëve është se cilësia e shërbimeve të ofruara nga TIA mbetet në përgjithësi "e kënaqshme dhe shumë e kënaqshme".

Një vështrim më i hollësishëm mbi performancën e TIA-s dhe arritjet e saj është publikuar në Buletinin Mjedisor dhe Social, të cilin mund ta gjeni pranë zyrave të TIA-s ose në websitin e TIA-s: www.tirana-airport.com.



Performanca Financiare

Si rrjedhojë e rritjes së trafikut ajror në më shumë se një milion e gjysmë pasagjerë, TIA ka arritur një xhiro vjetore prej 30 milionë Euro në vitin financiar 2010.

Gjatë gjithë vitit TIA ka qenë në përputhje me të gjitha konventat e nevojshme financiare.

Si dhe në vitet e mëparshme, pasqyrat financiare të TIA-s për vitin u përfunduan më 31 dhjetor 2010 të përgatitura në përputhje me SNRF dhe janë audituar nga një auditor i pavarur i cili lëshoi një opinion të pa kualifikuar për vitin 2010.

Në bazë të zhvillimeve të vitit 2010 dhe sidomos me liberalizimin e vizave nga mesi i dhjetorit, TIA parashikon një zhvillim të qendrueshëm për vitin 2011.

Tiranë, më 13.04.2011

